

ANEKSI 1 – TERMA REFERENCE PËR PROJEKTET TIK



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHITETIT**

SISTEMI ELEKTRONIK I SHPËRNDARJES SË UNIFORMËS

**Versioni 1.0
Data 28.06.2019**

FAQJA E KONTROLLIT TË DOKUMENTIT

Historiku i Versioneve dhe Ndryshimeve të Dokumentit

Data	Autori	Versioni	Shënime mbi Rishikimet
28.06.2019	DPPSH	V 1.0	

NËNSHKRIMET MIRATUESE

Miratoi: Drejtuesi i
Projektit

Miratoi: Përgjegjës për Proceset
TIK

Përgatiti: Përgjegjësi TIK

Përgatiti: <Funksioni i Anëtarit të Grupit të
Punës për Hartimin e Termave të referencës,
mund të shtohen të tjerë>

DPPSH

Person kontakti:

Rishikoi: Përgjegjësi i Sigurisë së TIK-ut

Të dhënat e personit të Kontaktit:

Emër/Mbiemër	
--------------	--

Pozicioni	
Adresa e-mail	
Nr. tel	

PËRMBAJTJA

<u>FAQJA E KONTROLLIT TË DOKUMENTIT</u>	2
<u>Historiku i Versioneve dhe Ndryshimeve të Dokumentit</u>	2
<u>NËNSHKRIMET MIRATUESE</u>	2
<u>PËRMBAJTJA</u>	3
<u>1. HYRJE</u>	5
<u>1.1. Përfituesi</u>	5
<u>1.2. Autoriteti Kontraktues</u>	5
<u>1.3. Historiku</u>	5
<u>1.4. Situata Aktuale në Sektor</u>	5
<u>2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA</u>	6
<u>2.1. Objektivi i Përgjithshëm</u>	6
<u>2.2. Qëllimi</u>	6
<u>2.3. Rezultatet që Duhet të Arrihen nga Kontraktori</u>	6
<u>3. SUPOZIMET DHE RISQET</u>	6
<u>3.1. Supozimet e Projektit</u>	6
<u>3.2. Risqet</u>	7
<u>4. QËLLIMI I PUNËS</u>	7
<u>4.1. Të Përgjithshme</u>	7
<u>4.1.1. Përshkrimi i detyrës</u>	7
<u>4.1.2. Hapësira gjeografike që do të mbulohet</u>	7
<u>4.1.3. Grupet e synuara</u>	7
<u>4.2. Puna specifike</u>	7
<u>5. LOGJISTIKA DHE KOHA</u>	8
<u>5.1. Vendndodhja</u>	8
<u>5.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave</u>	8
<u>6. RAPORTIMI</u>	8
<u>6.1. Kërkesat e Raportimin</u>	8
<u>6.2. Dorëzimi dhe Miratimi i Raporteve</u>	9
<u>7. KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA</u>	9
<u>8. GARANCIA</u>	10
<u>9. MIRËMBAJTJA</u>	10

<u>10.</u>	<u>PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR NDËRTIMIN E SISTEMIT</u>	10
<u>11.</u>	<u>AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT</u>	10
<u>12.</u>	<u>TË DREJTAT E KODIT TË APLIKACIONIT</u>	11
<u>13.</u>	<u>KËRKESAT FUNKSIONALE</u>	11
<u>13.1.</u>	<u>Kërkesa Funktionale</u>	11
<u>13.2.</u>	<u>Raporte</u>	11
<u>14.</u>	<u>KËRKESAT TEKNIKE</u>	11

1. HYRJE

1.1. Përfituesi /Autoriteti Kontraktues

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

1.2. Historiku

Uniforma është një nga elementet kryesore në identifikimin e punonjesit të policisë për qytetarët dhe brenda institucionit. Prej themelimit të Policisë së Shtetit në 1912 uniforma ka qenë pjesë përbërëse e saj. Në vite ajo ka ndryshuar modelin dhe ngjyrat duke ju përshtatur momenteve historike dhe nevojave. Struktura të ndryshme mbajnë uniforma të ndryshme në qëllim dallimin e detyrave që ushtrojnë. Prodhimi dhe shpërndarja e tyre bëhet duke zbatuar aktet ligjore në fuqi.

1.3. Situata Aktuale në Sektor

aktualisht situata e menaxhimit të porosisë dhe shpërndarjes së uniformës bëhet nëpërmjet një urdher porosisë totale dhe me shpërndarje nëpërmjet rrjetit të magazinave në Drejtoritë Vendore të Policisë në të gjithë vendit.

2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

2.1. Objektivi i Përgjithshëm

Objektivi i këtij programi është ndërtimi i një aplikacioni web që të mundësojë menaxhimin e uniformës nga regjistri i punonjësve me kartele personale, porosinë e uniformës, marrjen në dorezim, pagesat dhe raportet e statistikave në shërbim të këtij procesi.

2.2. Qëllimi

Qëllimi i këtij projekti është të arrihet të menaxhojë të gjithë procesin e pajisjes me uniforme të punonjësve të Policisë duke rritur transparencën dhe krijuar mundësinë e përfitimit të një produkti me cilësor në momentin e duhur.

2.3. Rezultatet që Duhet të Arrihen nga Kontraktori

- Kontraktori duhet të:
 1. Të dorëzojë një program web që mundëson dhe plotëson të gjitha kërkesat

teknike.

2. Programi duhet te aksesohet online nga cdo burim interneti.
3. Te mundesoje nje lidhje direkte Dark Fiber (VPN) me intranetin e Policise se Shtetit.
4. Te mirembaje, perditesoje programin sipas kerkesave pergjate kohezgjatjes se kontrates.

3. QËLLIMI I PUNËS

3.1. Të Përgjithshme

Proceset e realizimit te ketij projekti mbeshteten ne:

Ligji për Policinë e Shtetit.

Rregullorja e Brendshme e Policise se Shtetit.

Ligji për mbrojtjen e te dhenave personale.

4.1.1. Përshkrimi i detyrës

1. **Krijimi i një platforme web për menaxhimin e porositjes dhe shpërndarjes së uniformave të punonjësve të policisë duke përfshirë karta dhe sistem pikësh.**
2. **Ndërveprim me sistemin e burimeve njerzore në policinë e shtetit.**
3. **Lajmërimin e punonjësit për datën dhe vendin e marrjes së uniformës.**

4.1.2. Hapësira gjeografike që do të mbulohet

Republika e Shqipërisë.

4.1.3. Grupet e synuara

Punonjësit e Policisë së Shtetit

4.1.4. Siguria e sistemit

Niveli i sigurisë së sistemit, sipas klasave të disponueshmërisë, integritetit dhe konfidencialitetit është përcaktuar duke u bazuar në VKM Nr. 945, datë 02.11.2012 Për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”.

Masat e sigurisë do të jenë në përputhje me klasën e sigurisë të sistemit referuar VKM-së Nr. 945, datë 2.11.2012 dhe sipas udhëzimeve të nxjerra nga Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen Kompjuterike (ALCIRT).

4. LOGJISTIKA DHE KOHA

4.1. Vendndodhja

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Tiranë

Njësitë Shpenzuese në të gjithë Republikën e Shqipërisë

4.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave

Data e destinuar e fillimit është një javë nga nënshkrimi i kontratës dhe periudha e zbatimit të kontratës do të jetë 3 muaj nisur nga kjo datë.

5. RAPORTIMI

5.1. Kërkesat e Raportimit

Kontraktuesi do të paraqesë raportet e mëposhtme në shqip në origjinal dhe 2 kopje:

- **Raporti Fillestar** prej maksimumi 12 faqesh duhet të prodhohet pas dy javësh, nga fillimi i implementimit. Në raport Kontraktuesi duhet të përshkruaj gjetjet fillestare, progresi në mbledhjen e të dhënave, çdo vështirësi të pritura ose të hasura përveç programit të punës apo udhëtimeve të stafit. Kontraktuesi duhet të vazhdojë me punën e tij / saj derisa Autoriteti Kontraktues të dërgoj komente mbi raportin fillestar
- **Drafti i raportit përfundimtar** i faqeve maksimale 20 faqe. Ky raport duhet të dorëzohet jo më vonë se një muaj para përfundimit të periudhës së zbatimit të detyrave.
- **Raporti final** me të njëjtat specifika si drafti i raportit përfundimtar, inkorporimin e komenteve të pranuar nga palët në draft raport. Afati i fundit për dërgimin e raportit përfundimtar është 7 ditë pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar.

5.2. Dorëzimi dhe Miratimi i Raporteve

Raporti i përmendur më sipër duhet t'i dorëzohet Menaxherit të Projektit të identifikuar në kontratë. Menaxheri i Projektit është përgjegjës për aprovimin e raporteve.

6. KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA

- Komunikimi me sistemin RMIS për marrjen e strukture, pozicionin, funksionin, graden, emerimet, transferimet e punonjësve apo përdoruesve që do të aksesojnë

sistemin. Ne baze te struktures dhe pozicioneve do te percaktohen rolet dhe te drejtat e aksesit ne sistem.

7. GARANCIA

Sistemi duhet te jete funksional dhe nen garanci pergjate gjithe kohezgjatjes se kontrates te furnizimit me uniforma per punonjesit e Policise se Shtetit.

8. MIRËMBAJTJA

Marrëveshja e shërbimit të mirëmbajtjes së sistemit do të jetë sa kohezgjatja e kontrates se furnizimit me uniforma, në përputhje me dispozitat e VKM-së nr. 710, datë 21 gusht 2013, “Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”.

- Për mbajtjen në gatishmëri të Sistemit duhet të ofrohet gatishmëri dhe për një suport të vazhdueshëm. Suporti do të përfshijë të gjitha komponentët në tërësi të sistemit.
- Duhet të dokumentohet gjendja e sistemit para dhe pas çdo ndërhyrje, ndërhyrjet do të bëhen duke njoftuar paraprakisht.
- Operatori fitues duhet te kryeje kontrole për të gjithë sistemin ne rast mosfunksionimi te tij, kur dalin nga monitorimi apo mos funksionimi i lexuesit te kartave, probleme me monitorimin ne nivel institucioni apo nga Drejtoria e Pergjithshme, etj.
- Operatori fitues duhet te kryeje kontrole periodike të funksionimit të sistemeve në të gjitha institucionet e Policise se Shtetit ku do te perdoret sistemi, duke raportuar gjendjen. Ne fund te cdo kontrolli te mbahet akti i kontrollit i firmosur nga specialistet e shoqerise dhe punonjesi i institucionit ne prani te te cilit kryen kontrollat.
- Ne aktin e kontrollit te pasqyrohen paisjet ne te cilat u krye kontrolli dhe gjetjet per to ne rastin e mirefunksionimit ose mosfunksionimit.

Krahas problemeve teknike nevojitet gjithashtu te përkrahjet ne raport dhe njohja e sistemeve dhe përdorimi i tyre nga punonjësit e trajnuar.

9. PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR NDËRTIMIN E SISTEMIT

Nr.	Emërtimi	Njesia	Sasia	Çmimi
	Sistemi elektronik të shpërndarjes së uniformës	cope	1	
	Karta për Punonjësit e Policisë	cope	10000	
	Trajnime	jave	4	
	Mirembajtja	vite	4	
TOTALI ME TVSH (LEKË)				

10.AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT

Nr.	Emërtimi i fazës / Periudha kohore	M1	M2	M3	M4
1	Faza Përgatitore për sistemin software	X			
2	Faza e zhvillimit të sistemit software	X	X		
3	Faza e integritit dhe testimit të sistemit software		X	X	
4	Trajnimi i përdoruesve			X	
5	Marrja në dorëzim			X	
6	Fillimi i procesit të mirëmbajtjes				X

11.TË DREJTAT E KODIT TË APLIKACIONIT

Çdo e drejtë mbi kodin burim apo çdo dokumentacion që ka të bëjë me sistemin informatik nga kontraktuesi duhet t'i kalojë përfituesit në format elektronik dhe në letër dhe me DVD.

12.KËRKESAT FUNKSIONALE

1. **Krijimi i një platforme web për menaxhimin e porositjes dhe shpërndarjes së uniformave të punonjësve të policisë duke përfshirë karta dhe sistem pikësh.**
2. **Ndërveprim me sistemin e burimeve njerzore në policinë e shtetit.**
3. **Lajmërimin e punonjësit për datën dhe vendin e marrjes së uniformës.**

12.1.Funksionalitete dhe Bllokskema

- Sistemi do përpunoj te dhëna per uniformat e punonjësit te policisë: numrin e identifikimit, përmasat trupore, te dhënat e aksesit, piket, historikun, kontaktet.
- Punonjesit e policisë si fillim do pajisen nga kontraktori me nje karte identifikuese dhe me kredenciale per te aksesuar sistemin.
- Punonjesit do aksesojne sistemin nëpërmjet internetit me ane te kompjuterit ose pajisje mobile duke përdorur kredencialet e marra.
- Pas aksesimit do ti shfaqen te dhënat e tij bashke me piket dhe historik i porosive me statusin e tyre.
- Ne sistem punonjësit do ti shfaqen artikujt qe i takojnë sipas pozicionit te punës dhe gradës.
- Sistemi te jete i ilustruar me figura skematike qe punonjësi te orientohet per masën e produktit qe do zgjedhi.

- Ne nje porosi punonjësi te mund te zgjedhi disa artikuj.
- Te jete e mundur qe porosia te mund te modifikohet brenda nje afati kohor te përcaktuar paraprakisht
- Me bërjen gati te porosive nga kontraktori te realizohet njoftimi i punonjësit per vendin dhe datën ku mund ta terheqi porosinë.
- Kur punonjësi paraqitet per marrjen e porosisë behet identifikimi i tij me ane te kartës.
- Ofruesi i sherbimit cekon porosinë ne sistem dhe sistemi automatikisht kryen veprimet e gjenerimit te flet-daljet, përditësimin e pikëve dhe ndryshimin e gjendes te porosisë.
- Ne sistem punonjësit e caktuar te policisë te mund te monitorojnë procesin e shpërndarjes sipas strukturës se tyre organizative dhe te nxierin raporte.




Figura 1. Bllokskema funksionale e sistemit

- Përdoruesit
 - Porositsi

- Kryen porosite online, shikon statusin e pikëve dhe te porosive, modifikon porosite.
- Administratori i porosive
 - Shikon porosite e reja dhe ndryshon statusin e tyre.
- Dorezuesi i porosive
 - Cekon kartën dhe ndryshon statusin e porosive .
- Monitoruesit
 - Monitorojne mbarvajtjen e procesit te shpërndarjes.
- Manaxher
 - Cakton sasinë e pikëve fillestare dhe ben ndryshimet e tyre sipas rastit
- Administratori i sistemit
 - Administron perdoruesit

12.2. Raporte

Sistemi duhet te gjeneroj raporte dinamike per te gjithë informacionin qe përmban. Te mund te filtrohen sipas dëshirës nga përdoruesit. Raportet te mund te eksportohen ne format Excel, pdf, etj.

13.KËRKESAT TEKNIKE

- Sistemi duhet te jete platforme web i aksesueshem nëpërmjet intertetit.
- Sistemi duhet te jete online 99.99% te kohës.
- Te jete i mbrojtur nga sulmet dos, ddos, etj qe do pengonin aksesimin e tij.
- Sistemi duhet te suportojte te paktën 5000 perdorues njëkohësisht.
- Nderfaqja e sistemit duhet te jete e pershtatcme per tu hapur nga shfletuesit e internetit ne kompjuter dhe ne aparate mobile.
- Sistemi nuk duhet te lejoj aksesim te bazës se te dhënave direkt nëpërmjet internetit.
- Gjuha e programimit duhet te jete e orientuar ne objekte.
- Sistemi duhet te kete arkitekture MVC.
- Databasa duhet te jete e optimizuar, indeksuar, e skeduluar per back up, e auditueshme.
- Aksesimi i sistemit te realizohet vetëm duke përdorur url me https.
- Sistemi duhet te ngarkohet ne aplikacion server.
- Sistemi te shfaqij nje harte me gjithë pikat e shpërndarjes.
- Software

Databaza

Lloji	Databaze Relacionale
Architecture	Një skemë e veçantë për këtë sistem
Databazë	Po, të dhënat duhet të jenë të normalizuara dhe mos të përsëriten ndërmjet tabelave
Të dhënat	Duhet të jenë të kriptuara dhe të shikohen nga njeriu vetëm nëpërmjet platformës dhe jo me anë të RDBMS
Foto	Të ruhen si fusha në database si BLOB

Platforma Web

Lloji	Web Application
Model	MVC, model me 3 shtresa
Funksionalitetet	Sipas kërkesave
Ndërfaqja me përdoruesin	Responsive
Identifikimi I përdoruesve	Përdorues dhe Fjalëkalim
Ndërlidhja e përdoruesve me raportet	Automatike nëpërmjet structures organizative të policisë së shtetit
Ruajta e gjëndjes së përdoruesit	Në Sesion
Ndërfaqja	Të përfshihen HTML5, CSS3

Webservice lidhjen me sistemin e burimeve njerzore

Lloji	Rest
Sistemi Operativ	Cross-platform
Anotime për klasat burim (POJO)	Të suportojë: @Path, @GET, @PUT, @POST, @DELETE, @HEAD
Anotime për parametrat e metodave	Të suportojë: @PathParam, @QueryParam, @MatrixParam, @HeaderParam, @CookieParam, @FormParam, @DefaultValue, @Context
Siguria	Të implementoj OAuth2.0 as RFC 7523
Lidhje me databasën	Hibernate/JPA
Funksionalitete	Sipas kërkesave
Implementim SSL	Po

SSL

Kompatibiliteti	Me pjesën më të madhe të shfletuesve të internetit dhe pajisjeve mobile
Standard	X.509 certificates
Kriptim	Symmetric 256-bit encryption
RSA public-key SHA-2 algorithm	Supports hash functions: 256, 384, 512
ECC public-key cryptography	Supports hash functions: 256 and 384
Server licensing	Unlimited
2048-bit public key encryption	Yes
Lloji	Wildcard SSL

Periudha

4-vite

-Fund-